



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT, E
SHKENCËS DHE E
TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF
EDUCATION, SCIENCE &
TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA
OBRAZOVANJE, NAUKU I
TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Office of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Zbatimi i Standardeve të përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë

NUMËR: MASHT 12 / 2006

DATË: 25. 04. 2006

Në bazë të nenit 1.3 pika ç) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 6.1 paragrafi (a), të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është zbatimi i Standardeve të përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë, si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit.

Neni 2

Kurrikula

Standardet e përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë i janë bashkëngjitur këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 3

Zbatueshmëria

1. Këto Standarde të përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë zbatohen nga viti shkollor 2006/2007.
2. Me zbatimin e Standardeve të përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë shfuqizohen Standardet e deritashme.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me dt. _____ .

Agim Veliu, Ministër

